



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 19

2000

Korrik

PËRMBAJTJA

Ligj nr.8633
datë 3.7.2000

Për ratifikimin e "Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim
"Projekti i Reformës Ligjore dhe Gjyqësore", ndërmjet
Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për
Zhvillim (IDA)"

919

L I G J
Nr.8633, datë 3.7.2000

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË PËR ZHVILLIM “PROJEKTI I REFORMËS LIGJORE DHE GJYQËSORE” NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e Kredisë për Zhvillim “Projekti i Reformës Ligjore dhe Gjyqësore” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2690, datë 7.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

NUMRI I KREDISË 3327 ALB

MARRËVESHJA E KREDISË PËR ZHVILLIMIN

MARRËVESHJE, datë 18 prill 2000, ndërmjet REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“Huamarrësi”) dhe ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN (“Organizata”).

MEQËNËSE Huamarrësi, duke qënë i kënaqur përsa i përket fizibilitetit dhe përparësisë së Projektit që përcaktohet në Kreun 2 të kësaj Marrëveshjeje, ka kërkuar që Organizata të japë ndihmën në financimin e Projektit;

MEQËNËSE Organizata është dakord, duke u bazuar, ndër të tjera, në deklaratën e sipërmendur, për t’i dhënë Kredinë Huamarrësit, me termat dhe sipas kushteve që parashikohen në këtë Marrëveshje;

PRANDAJ, palët me këtë Marrëveshje bien dakord si vijon:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

Seksioni 1.01 “Kushtet e Përgjithshme të Zbatueshme për Marrëveshjen e Kredisë për Zhvillimin” të Organizatës, datë 1 janar 1985 (siç janë ndryshuar deri më 2 dhjetor 1997), me modifikimet që parashtrihen më poshtë (“Kushtet e Përgjithshme”), përbëjnë pjesë themelore të kësaj Marrëveshjeje:

(a) Një paragraf i ri, (c), i shtohet Seksionit 3.04, si vijon:

“Në qoftë se Organizata në çdo moment do të marrë një shumë më të vogël sesa shuma e

plotë e kërkueshme në atë moment sipas Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit, Organizata do të ketë të drejtë ta ndajë, si dhe ta zbatojë shumën e marrë në çfarëdolloj mënyre dhe për ato qëllime të Marrëveshjes së Kredisë që do t'i vendosë vetë Organizata me diskrecionin e saj.”; dhe

(b) Seksioni 11.01 ndryshohet duke zëvendësuar fjalën “radiogram” me fjalën “fax” në fjalinë e dytë, si dhe duke shtuar një fjali të re në fund të këtij Seksioni si vijon: “Dërgesat që bëhen me fax duhet të konfirmohen me postë.”

Seksioni 1.02. Në qoftë se konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrje të kësaj Marrëveshjeje kanë atë kuptim që parashikohet aty dhe termat shtesë, që vijojnë kanë kuptimet e mëposhtme:

(a) “Fakulteti” do të thotë Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës, Shqipëri;

(b) “Shkolla e Magjistraturës” do të thotë institucioni arsimor, që zotëron dhe menaxhon Huamarrësi, për formimin zyrtar të gjyqtarëve profesionistë, që përcaktohet në paragrafin B.2 (a) të Shtesës II të kësaj Marrëveshjeje;

(c) “MD” do të thotë Ministria e Drejtësisë së Huamarrësit;

(d) “NjZP” do të thotë “Njësia për Zbatimin e Projektit,” që përcaktohet në Seksionin 3.04 të kësaj Marrëveshjeje;

(e) “Llogari e veçantë” do të thotë llogaria, që përcaktohet në Seksionin 2.02(b) të kësaj Marrëveshjeje;

(f) “Këshilli Mbikëqyrës” do të thotë Këshilli Mbikëqyrës për Reformën Juridike i kryesuar nga Ministri i Drejtësisë dhe me përberjen si vijon: Kryetari i Gjykatës së Lartë, Dekani i Fakultetit, Drejtoresha e Shkollës së Magjistraturës, Zëvendësministrja e Financave, si dhe Drejtori i Qendrës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, Këshilli i cili përcaktohet në Seksionin 3.04 të kësaj Marrëveshjeje.

(g) “Inspektorati” do të thotë Zyra e Inspektoratit Gjyqësor që është vendosur pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë së Huamarrësit për vlerësimin e veprimtarisë gjyqësore si dhe për shqyrtimin e ankesave ndaj gjyqtarëve të veçantë, Zyrë e cila përcaktohet në paragrafin B.4(a) të Shtesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01. Organizata bie dakord, për t'i dhënë Huamarrësit si hua, sipas termave dhe kushteve të paraqitura ose të treguara në Marrëveshjen e Kredisë për Zhvillimin, një shumë në monedha të ndryshme që barazvlerësohet me gjashtë milione e gjashtëqind mijë Të Drejta të Veçanta për Marrjen e Fondeve (DVFMF 6,600,000).

Seksioni 2.02. (a) Shuma e Kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë sipas dispozitave të parashikuara në Shtesën I 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzime të bëra (ose, në qoftë se Organizata është dakord, që do të bëhen) që përfaqësojnë koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për Projektin dhe që janë caktuar për financimin nga Kredia.

(b) Huamarrësi ka të drejtë, për qëllimet e Projektit, të hapë dhe të mbajë një llogari të veçantë në dollarë për depozitat në një bankë sipas termave dhe kushteve që janë të kënaqshme për Organizatën, përfshirë mbrojtjen e duhur kundër kompensimeve, konfiskimeve dhe sekuestrimeve. Depozitimet në Llogarinë e Veçante dhe pagesat do të bëhen në përputhje me Kreun 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.03. Data e Përfundimit do të jetë 31 dhjetor 2004, ose një datë e mëvonshme që do të vendoset nga Organizata. Organizata do t'ia njoftojë Huamarrësit menjëherë në qoftë se ajo vendos një datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi i paguan Organizatës një detyrim angazhimi që përcaktohet nga Organizata në 30 qershor të çdo viti, si përqindje e shumës së kredisë të patërhequr herë pas herë në periudhat kohore të caktuara.

Kjo përqindje nuk mund të kapërcejë një të dytën e 1 përqindshit në vit (1/2 e 1%).

(b) Detyrimi i angazhimit do të llogaritet: (i) nga data që i takon gjashtëdhjetë ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje (data e akumulimit) deri në datat respektive, kur shumat do të tërhiqen nga

Huamarrësi nga Llogaria e Kredisë ose data kur ato do të anulohen; dhe (ii) sipas interesit të vendosur me 30 qershor që i paraprin menjëherë datës së akumulimit dhe sipas interesave të tjera që mund të jenë vendosur kohë pas kohë pas kësaj në zbatim të paragrafit (a). Interesi i vendosur më 30 qershor të çdo viti do të zbatohet që nga data tjetër në atë vit e treguar në Seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Detyrimi i angazhimit do të paguhet: (i) në ato vende ku e kërkon Organizata në mënyrë të arsyeshme; (ii) pa kufizime të çfarëdolloji qofshin të vendosura nga, ose në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e përcaktuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme ose në ndonjë monedhë apo monedhë të tjera të pranueshme që mund të jenë përcaktuar ose përzgjedhur herë pas herë sipas dispozitave të atij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi do t'i paguajë Organizatës një detyrim për shërbimin në masën tre të katërtat e një përqindeshit (3/4 e 1%) në vit të shumës kryesore së Kredisë të tërhequr dhe të pashlyer kohë pas kohe.

Seksioni 2.06. Detyrimet e angazhimit dhe ato të shërbimit do të paguhet një herë në gjashtë muaj me 1 Shkurt dhe 1 Gusht të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) Duke iu nënshtuar paragrafeve (b), (c) dhe (d), Huamarrësi do të shlyejë shumën kryesore të Kredisë me këste gjashtëmujore që do të paguhet çdo 1 shkurt dhe 1 Gusht duke filluar nga 1 Gushti 2010 deri më 1 Shkurt 2040. Çdo këst, duke përfshirë edhe këstin që duhet paguar më 1 Shkurt 2020, do të jetë një përqind (1%) e shumës kryesore, dhe pas këtij, çdo këst do të jetë dy përqind (2%) e shumës kryesore.

(b) Kurdoherë që: (i) produkti kombëtar bruto (PKB) për frymë i Huamarrësit, i përcaktuar nga Organizata, do të ketë kaluar për tre vjet rradhazi nivelin e vendosur çdo vit nga Organizata me qëllim për të përcaktuar nëse Huamarrësi i përmbush kriteret për të shfrytëzuar burimet financiare të Organizatës; dhe (ii) Banka e konsideron Huamarrësin të besueshëm për t'i dhënë hua Bankare, Organizata ka të drejtë, pas rishikimit dhe miratimit nga Drejtoret Ekzekutive të Organizatës dhe pas vlerësimit përkatës nga ana e tyre të zhvillimit të ekonomisë së Huamarrësit, të modifikojë shlyerjen e kësteve të përcaktuar në paragrafin (a):

(A) Duke i kërkuar Huamarrësit të shlyejë dyfishin e shumës të secilit këst që nuk është bërë ende i pagueshëm përderisa të shlyhet shuma kryesore e Kredisë; dhe

(B) Duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë shlyerjen e shumës kryesore të kredisë në datën e pagesës së gjashtëmujorit të parë të përcaktuar në paragrafin (a) më sipër me plotësimin e 6 muajve ose me shumë pas datës, në të cilën Organizata njofton Huamarrësin se kushtet e përcaktuara në këtë paragraf (b) kanë ndodhur, me kusht që të jetë plotësuar një periudhë shtesë e lejuar prej jo më pak se 5 vjetësh për një shlyerje të tillë të shumës kryesore.

(c) Në qoftë se kërkohet nga Huamarrësi, Organizata mund të rishikojë ndryshimet e përmendura në paragrafin (b) më sipër për të përfshirë, në vend të disa ose të gjithë rritjes së shumave të kësteve të tilla, pagesa e interesave në një përqindje vjetore, për të cilën është rënë dakord me Organizatën, për shumën kryesore të Kredisë së marrë dhe të pashlyer në periudha kohe të caktuara, me kusht që, sipas gjykimit të Organizatës, një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin kohë shtesë të lejuar për të siguruar shlyerjen e modifikuar si më lart.

(d) Në qoftë se Organizata konstaton, në çdo kohë, pas modifikimit të kushteve sipas paragrafit (b) më sipër, se gjendja ekonomike e Huamarrësit është përkeqësuar në mënyrë të konsiderueshme, Organizata mund, me kërkesë të Huamarrësit, të modifikojë përsëri kushtet e shlyerjes për t'u konformuar me kreun e kësteve siç parashikohet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës specifikohet këtu në kuptimin e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 3 Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Huamarrësi deklaron se angazhohet për përmbushjen e objektivave të Projektit siç parashikohen në Kreun 2 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe se do ta kryejë Projektin nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë me devotshmëri e efikasitet dhe në përputhje me praktikat

ambientale, financiare, administrative, institucionale dhe inxhinjrike, dhe se do të sigurojë, kurdo që të nevojitet, fonde, mjete, shërbime dhe burime të tjera që kërkohen për Projektin.

(b) Pa u kufizuar në parashikimet e paragrafit (a) të këtij Seksioni, si dhe me përjashtim të rastit kur Huamarrësi dhe Organizata bien dakord për ndryshime, Huamarrësi do ta zbatojë Projektin në përputhje me Programin e Zbatimit të parashikuar në Kreun 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Me përjashtim të rastit kur Organizata nuk është dakord, sigurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulentëve për Projektin dhe financimi i tyre nëpërmjet procedurave të Kredisë do të rregullohen nga dispozitat e Kreut 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03. Për qëllimet e Seksionit 9.07 të Kushteve të Përgjithshme dhe duke mos u kufizuar vetëm në to, Huamarrësi:

(a) do të përgatisë, në bazë të udhëzimeve të pranueshme për Organizatën, një plan për zbatimin e ardhshëm të Projektit, plan të cilin duhet t'ia dërgojë Organizatës jo më vonë se 6 muaj pas Ditës së Mbylljes ose në një ditë të mëvonshme siç mund të bihet dakord për këtë qëllim ndërmjet Huamarrësit dhe Organizatës; dhe

(b) do t'i krijojë mundësi të arsyeshme Organizatës për të këmbyer pikëpamje me Huamarrësin mbi këtë plan.

Seksioni 3.04. NjZP, në masën e saj të përgjegjesisë, me stafin e me mjetet e tij, të kënaqshme për Organizatën, është përgjegjës për mbarëvajtjen e përditshme të Projektit, si dhe monitorimin e progresit të tij. NjZP do të kryejë detyrat e tij nën kontrollin e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe do të raportojë drejtpërdrejt në Këshillin Mbikëqyrës. Drejtori i Projektit i NjZP është përgjegjës për menaxhimin dhe koordinimin në tërësi të Projektit.

Neni 4

Marrëveshjet financiare

Seksioni 4.01. (a) Huamarrësi do të mbajë një sistem menaxhimi financiar, duke përfshirë procesverbalet, regjistrimet e llogarite, si dhe të përgatisë raporte për gjendjen financiare në një format të pranueshëm për Organizatën, të përshtatshëm për të pasqyruar operacionet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me Projektin.

(b) Huamarrësi

(i) do t'i mbajë procesverbalet, regjistrimet, llogaritë dhe raportet mbi gjendjen financiare të përmendura në paragrafin (a) të këtij Seksioni, si dhe regjistrimet, procesverbalet dhe llogaritë për Llogarinë e Veçantë për çdo vit fiskal të kontrolluar, në përputhje me standardet e kontrollit të pranueshme për Organizatën, që zbatohen në mënyrë të vazhdueshme nga kontrollorë të pavarur të pranueshëm për Organizatën;

(ii) do t'i dërgojë Organizatës menjëherë sapo të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti të tillë, (A) kopje të vërtetuar të raportit të gjendjes financiare të përmendur në paragrafin (a) të këtij Seksioni për atë vit që i është nënshtruar kontrollit financiar; dhe (B) një opinion për raportin e gjendjes financiare, regjistrimet, procesverbalet dhe llogaritë, si dhe për raportin e kontrollit, nga kontrollorët e përmendur; opinionin duhet të jetë i detajuar dhe për ato çështje që mund të kërkohen nga Organizata në mënyrë të arsyeshme; dhe

(iii) do t'i dërgojë Organizatës informacione të tjera në lidhje me regjistrimet dhe llogaritë, dhe të kontrollit të tyre, si dhe në lidhje me kontrollorët, që mund të kërkohen nga Organizata herë pas herë dhe në mënyrë të arsyeshme.

(c) Për të gjitha shpenzimet përsa i përket tërheqjeve nga Llogaria e Kredisë që janë bërë në bazë të raporteve të shpenzimeve, Huamarrësi:

(i) do të mbajë ose do të marrë masat që të mbahen, në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni, regjistrimet dhe llogaritë e veçanta që pasqyrojnë shpenzime të tilla;

(ii) do të ruajë, të paktën deri një vit pasi Organizata të ketë marrë raportin e kontrollit për vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga Llogaria e Kredisë, të gjitha regjistrimet (kontrata, porositë, faturat, dëftesat, vertetimet e pagesave, procesverbalet e marrjes në dorëzim ose të tërheqjes dhe dokumente të tjera) që evidentojnë këto shpenzime;

(i) do të mundësojë përfaqësuesit e Organizatës të ekzaminojnë regjistrime të tillë; dhe

(ii) do të sigurojë që regjistrime dhe llogari të tilla të përfshihen në kontrollin vjetor të parashikuar në paragrafin (b) të këtij Seksioni dhe se raporti i një kontrolli të tillë të përmbajë një opinion të veçantë të kontrollorëve nëse raportet për shpenzimet e paraqitura gjatë një viti të tillë fiskal, së bashku me procedurat dhe kontrollet e brendshme për përgatitjen e tyre, janë të besueshme për të mbështetur tërheqjet përkatëse.

Seksioni 4.02. (a) Pa u kufizuar në dispozitat e Seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të hartojë një plan me detyrime kohore të pranueshëm për Organizatën për fuqizimin e sistemit financiar të menaxhimit të parashikuar në paragrafin (a) të Seksionit 4.01 me qëllim që të mundësojë Huamarrësin, jo më vonë se 30 qershor 2001, ose në një ditë të mëvonshme që do të pranohet nga Organizata, të përgatisë raportet menaxhuese tremujore të Projektit, të pranueshme për Organizatën, çdonjeri prej tyre duhet:

(i) (A) të paraqesë burimet faktike dhe kërkesat e fondeve për Projekt, në mënyrë të përmbledhur dhe për periudhën që mbulon një raport i caktuar, dhe burimet e planifikuara dhe kërkesat e fondeve për Projektin për periudhën gjashtëmujore në vijim të periudhës që mbulon raportin, dhe (B) të tregojë veç e veç shpenzimet e financuara nga Kredia gjatë periudhës që mbulon raportin dhe shpenzimet e planifikuara për t'u financuar nga Kredia për periudhën gjashtëmujore që pason periudhën e që mbulon raportin në fjalë;

(ii) (A) të përshkruajë progresin fizik në zbatimin e projektit, në mënyrë të përmbledhur dhe për periudhën që mbulon një raport i caktuar; dhe (B) të shpjegojë ndryshimet ndërmjet arritjeve faktike dhe objektivave të zbatimit të planifikuara më parë; dhe

(iii) të paraqesë gjendjen e prokurimit sipas Projektit dhe shpenzimet sipas kontratave të financuara nga Kredia, në përfundim të periudhës që mbulohet nga raportin.

b) Me plotësimin e planit të veprimit të parashikuar në paragrafin (a) të këtij Seksioni, Huamarrësi do të përgatisë, në përputhje me udhëzimet e pranuar nga Organizata, dhe t'i dërgojë Organizatës, jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të çdo tremujori, një Raport të Menaxhimit të Projektit për periudhën në fjalë.

Neni 5

Mënyrat e Mbrojtjes së Organizatës

Seksioni 5.01. Në bazë të Seksionit 6.02(1) të Kushteve të Përgjithshme, një kusht tjetër që vijon specifikohet, pikërisht, se Huamarrësi nuk ka nxjerrë një regjim juridik të kënaqshëm për Zgjidhjen Alternative të Konfliktive brenda 31 dhjetorit 2000.

Neni 6

Data e hyrjes në fuqi; Mbarimi

Seksioni 6.01. Kushtet që vijnë janë specifikuar si kushte shtesë për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Zhvillimit të Kredisë në kuptimin e Seksionit 12.01 (b) të Kushteve të Përgjithshme:

(a) reformën juridike dhe me aftësitë prokuruese, financiare, menaxhuese/paguese të përshtatshme, si dhe me ambiente zyresh dhe pajisje të përshtatshme që do t'i sigurohen NjZP-së; dhe

(b) Ministria e Drejtësisë të ketë miratuar e të ketë filluar zbatimin e Projektit që lidhet me sistemin financiar të menaxhimit, të pranueshëm për Organizatën.

Seksioni 6.02. Koha nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje specifikohet këtu në kuptimin edhe për efekte të Seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 7

Përfaqësuesi i Huamarrësit; Adresat

Seksioni 7.01. Ministria e Financave e Huamarrësit caktohet si përfaqësuese e Huamarrësit në kuptimin e Seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat vijuese specifikohen në kuptim të Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

Për Huamarrësin: Ministria e Financave, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri. Telex: 4295 Komplan, Fax: 355 42 28494

Për Organizatën: International Development Association, 1818 H Street, N.W., Washington, D.C. 20433, USA. Cable address: INDEVAS Washington, D.C.; Telex: 248423 (MCI) ose 64145 (MCI); Fax. (202) 477 6391.

Palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, e nënshkruajnë Marrëveshjen në emër të tyre në Distriktin Kolumbia, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në ditën dhe në vitin e përshkruar më sipër.

SHQIPËRIA Nga Përfaqësuesi i Autorizuar

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E ZHVILLIMIT

Nga Zëvendës Presidenti Rajonal për Europën dhe Azinë Qendrore.

SHTESË I

Tërheqja e Shumave të Kredisë

1. Tabela e mëposhtme paraqet Kategoritë e zërave që do të financohen nga shumat e Kredisë, ndarjen e shumave të Kredisë për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për çdo zë që do të financohet në çdo Kategori:

Kategoritë	Shuma e Kredisë së Akorduar (E shprehur në ekuivalentin DVMF)	%-ja e shpenzimeve që do të financohen
(1) Punimet	730 000	85%
(2) Mallrat	2 200 000	100% e shpenzimeve të drejt-përdrejta, 100% të shpenzimeve të brendshme (ex-factory costs) për zëra të prodhuar brenda vendit, dhe 80% të zërave të tjerë të siguruar brenda vendit
(3) Asistenca teknike	3.170.000	100%
(4) Kostot Operuese shtesë	140.000	90%
(5) Të paakorduara	360 000	
TOTALI	6 600 000	

2. Për qëllimet e këtij Kreu:

(a) termi “shpenzime të huaja” do të thotë shpenzime në monedhat e vendeve të tjera, përveç atij të Huamarrësit për mallrat ose shërbimet të furnizuara nga territori i çdo vendi përveç atij të Huamarrësit;

(b) termi “shpenzime të brendshme” do të thotë shpenzime në monedhen e Huamarrësit për mallrat dhe shërbimet e furnizuara nga territori i Huamarrësit dhe

(c) termi “kosto operuese shtesë” do të thotë shpenzime shtesë nga Ministria e Drejtësisë për zbatimin, menaxhimin, vezhgimin dhe mbikëqyrjen e Projektit, përfshirë kostot e arsyeshme të pajisjeve të zyrave, abonimin në materialet ligjore përkatëse, mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave, mbajtjen në funksionim të automjeteve, korrespondencat dhe rrogat, por duke përjashtuar rrogat e nëpunësve të shërbimit civil të Huamarrësit.

3) Pavarësisht nga paragrafi 1 i mësipërm, nuk do të bëhen tërheqje për:

(a) pagesat për shpenzimet para datës së kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim tërheqjet, në një shumë përmblendhëse që nuk e kalon ekuivalentin prej 75.000 DVMF, mund të bëhen për pagesat që janë bërë për shpenzime para asaj date, por pas 6 dhjetorit 1999 dhe

(b) pagesat e bëra për shpenzime sipas Kategorisë (1) për rehabilitimin ose zgjerimin e ambienteve ekzistuese të Fakultetit me përjashtim të rastit kur në opinionin e Organizatës është bërë progres i kënaqshëm në zbatimin e programit reform të Fakultetit.

4) Organizata mund të kërkojë tërheqje nga Llogaria e Kredisë që do të bëhen në bazë të raporteve të shpenzimeve për: (i) mallrat sipas kontratave që kushtojnë më pak se \$50.000; (ii) konsulentët individuale sipas kontratave që kushtojnë më pak se \$20.000 secili; (iii) firmat konsultuese sipas kontratave që kushtojnë më pak se \$50.000 secila; (iv) shpenzime operuese të tjera dhe trajnime; dhe (v) punimet sipas kontratave që kushtojnë më pak se \$100.000 secila; sipas atyre afateve dhe kushteve që Organizata do t'ia specifikojë Huamarrësit me anën e një njoftimi.

SHTESË II Përshkrimi i Projektit

Objektivi i Projektit synon të ndihmojë Huamarrësin të përmirësojë aftësinë e sistemit gjyqësor të Huamarrësit, si dhe të institucioneve të tjera ligjore përkatëse.

Projekti përban pjesët e mëposhtme, të cilat mund të jenë objekt i ndryshimeve kur Huamarrësi dhe Organizata bien dakord herë pas herë për të arritur objektiva të tilla:

Pjesa A: Arsimi Juridik

1. Zhvillimi dhe forcimi i aftësisë institucionale të Fakultetit nëpërmjet sigurimit të trajnimit të trupit mësimdhënës;

2. Përgatitja e materialeve trajnuese, duke përfshirë marrëveshjet shkollore binjakzuese për Fakultetin, nëpërmjet sigurimit të asistencës teknike; dhe

3. Rehabilitimi dhe zgjerimi i ambienteve ekzistuese të Fakultetit, nëpërmjet sigurimit të pajisjeve e mallrave, si dhe të punimeve.

Pjesa B: Sistemi Gjyqësor

1. Administrata gjyqësore dhe sistemet e menaxhimit të çështjeve

a) Përmirësimin në administrimin e gjykatave, veçanërisht në menaxhimin e çështjeve gjyqësore të bazuar në rekomandimet e vlerësimeve diagnostikuese, siç është rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Organizatës;

b) Zbatimin e politikës së reformave përsa i përket rishikimit të administratës gjyqësore, të proceseve dhe të procedurave për rastet konkrete, për përmirësimin e sistemit gjyqësor;

c) Sigurimi i materialeve e pajisjeve, si dhe shërbimeve për një zbatim me faza të rekomandimeve të vlerësimeve diagnostikuese, për të cilat është rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Organizatës, me Gjykatën e Lartë dhe fillimisht me dy gjykata të tjera, si dhe gjatë zbatimit të mëtejshëm të Projektit, edhe me gjykatat e tjera; dhe

d) Fuqizimin e aktiviteteve koordinuese me donatorë të tjerë të asistencave teknike ekzistuese dhe të programeve investuese për pajisjet që kanë lidhje me Projektin.

2. Trajnimi Gjyqësor

a) Forcimi i programit të Shkollës së Magjistraturës për një edukim gjyqësor të vazhdueshëm, si dhe konsolidimi i një programi trajnimi profesional për administratorët e gjykatave;

b) Sigurimi i asistencës teknike për trajnimin e gjyqtareve, përgatitja e materialeve mësimdhënëse, e trajnimit të administratorëve të gjykatave; dhe

c) Pasurimin e Bibliotekës së Shkollës së Magjistraturës, laboratorëve kompjuterikë dhe të sallave gjyqësore imituese.

3. Forcimin e procesit për vënien në jetë në mënyrë detyruese të vendimeve gjyqësore në çështjet civile.

a) Sigurimi i asistencës teknike për të konceptuar dhe hartuar një program veprimi për të trajtuar problemet dhe dobësitë e identifikuar në procesin e vënies në jetë të vendimeve gjyqësore; dhe

b) Vënien në jetë të këtij program veprimi nëpërmjet sigurimit të asistencës teknike, trajnimit dhe të materialeve.

4. Inspektorati gjyqësor

a) Sigurimi i shërbimeve të një eksperti vendas për të ekzaminuar aktivitetet aktuale të inspektimit nën Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë të Huamarrësit, si dhe dhënia e rekomandimeve për politikën e reformave, asistencës teknike dhe mbështetjes materiale që nevojitet për të fuqizuar Zyrën e Inspektoratit; dhe

b) Zbatimin e këtyre rekomandimeve nëpërmjet sigurimit të asistencës teknike, trajnimit, pajisjeve dhe materialeve.

Pjesa C: Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve për konfliktet tregtare

Ngritja e Qendrës së Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit të Konfliktëve Tregtare si një organizatë joqeveritare.

Pjesa D: Shpërndarja e Informacionit Juridik

Ngritja e sistemit të centralizuar të informacioneve juridikë të Huamarrësit dhe të ambienteve përkatëse për shpërndarjen e informacionit juridik.

Pjesa E: Menaxhimi i Projektit

Ngritja e një NjZP brenda Ministrisë së Drejtësisë, si dhe gjetja e ambienteve për stafin e NjZP, nëpërmjet sigurimit të asistencës teknike, të trajnimit dhe të pajisjeve.

Projekti planifikohet të përfundojë më 30 qershor 2004.

SHTESË III

Prokurimi dhe shërbimet e konsulentëve

Seksioni I. Prokurimi i Mallrave dhe Punimeve

Pjesa A: Të përgjithshme

Mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me (a) parashikimet e Seksionit I të botimit “Udhëzimet për Prokurimin në lidhje me Borxhet e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZh) dhe të Kredive të Organizatës Ndërkombëtare për Zhvillim”, botuar nga Banka në Janar 1995 dhe rishikuar në Janar dhe Gusht 1996, Shtator 1997 dhe Janar 1999 (“Udhëzimet”), si dhe të dispozitave të Pjesëve të Seksionit I që vijojnë:

Pjesa B: Tenderat Konkurses Ndërkombëtarë

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, mallrat dhe punimet do të sigurohen sipas kontratave të përfunduara në përputhje me dispozitat e Seksionit II të Udhëzimeve dhe të paragrafit 5 të Shtojcës 1 bashkëngjitur.

2. Parashikimet në vijim do të zbatohen për mallrat dhe punimet që do të sigurohen sipas kontratave të përfunduara në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të kësaj Pjese B.

Preferencë për mallrat e prodhuara në vend dhe për kontraktuesit vendas.

Parashikimet e paragrafeve 2.54 dhe 2.55 të Udhëzimeve dhe të Shtojcës 2 bashkëngjitur do të zbatohen për mallrat e prodhuara në territorin e Huamarrësit dhe për punimet që do të kryhen nga kontraktuesit vendas.

Pjesa C: Procedura të tjera Prokuruese

Blerjet Ndërkombëtare

Mallrat që vleresohen se kushtojnë më pak se 50,000 dollarë (ose ekuivalenti në monedha të tjera) për çdo kontrat, deri në një çmim permbljedhes që nuk i kalon të 50,000 dollare (ose ekuivalenti në monedha të tjera), mund të sigurohen sipas kontratave të përfunduara në bazë të procedurave të blerjeve ndërkombëtare në përputhje me paragrafet 3.5 dhe 3.6 të Udhëzimeve.

Pjesa D: Rishikimi nga Organizata i Vendimeve Prokuruese

1. Planifikimi prokurues

Para lëshimit të ofertave për të marrë pjesë në tenderat e kontratave, plani prokurues i propozuar për Projektin, do t'i jepet Organizatës që ajo të bëjë rishikimin dhe miratimin, në përputhje me paragrafin 1 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe

punimeve do të bëhet në përputhje me ato plane prokuruese që do të jenë miratuar nga Organizata dhe në përputhje me paragrafin 1.

2. Rishikimi paraprak

a) Në lidhje me secilën kontratë për mallra të siguruar nëpërmjet procedurave ndërkombëtare të tenderave të paraqitura në Pjesën B të kësaj Shtese dhe kontratat e punimeve, do të zbatohen procedurat e paraqitura në paragrafet 2 dhe 3 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve.

b) Në lidhje me kontratën e parë për mallra në përputhje me procedurat për blerje ndërkombëtare të paraqitura në Pjesën C të kësaj Shtese do të zbatohen procedurat e mëposhtme:

(i) për ekzekutimin e kontratës së parë sipas procedurave të blerjes, Huamarrësi do t'i paraqesë Organizatës një raport krahasues dhe vlerësues të kuotave të marra;

(ii) para ekzekutimit të kontratës së parë të siguruar sipas procedurave të blerjes, Huamarrësi do t'i japë Organizatës një kopje të specifikimeve dhe të projekt kontratës; dhe

(iii) do të zbatohen procedurat e paraqitura në paragrafet 2(f), 2(g) dhe 3 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve.

1. Rishikimi i mëvonshëm

Në lidhje me secilen kontratë që nuk rregullohet nga paragrafi 2 i kësaj Pjese, do të zbatohen procedurat e paraqitura në paragrafin 4 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve.

Seksioni II. Punësimi i Konsulentëve

Pjesa A: Të përgjithshme

Shërbimet e konsulentëve do të sigurohen në përputhje me (a) dispozitat e Hyrjes dhe të Seksionit IV të “Udhëzimeve: Zgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore” botuar nga Organizata në janar 1997 dhe rishikuar në shtator 1997 dhe janar 1999, dhe objekt i modifikimeve të paraqitura në paragrafin 2 të kësaj Pjese A (Udhëzimet për Konsulentin), dhe (b) në përputhje me dispozitat e Pjesëve vijuese të këtij Seksioni II.

Pjesa B: Përzgjedhja në bazë të Cilësisë dhe të Kostos

Përveçse kur parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, shërbimet e konsulentëve (duke përfshirë siguruesit e trajnimeve dhe shkollat e binjakëzuara) do të sigurohen sipas kontratave të përfunduara në përputhje me dispozitat e Seksionit II të Udhëzimeve për Konsulentin, paragrafi 3 i Shtojcës 1, Shtojca 2, si dhe paragrafet 3.13 deri 3.18 të zbatueshëm për përzgjedhjen e konsulentëve në bazë të cilësisë dhe koston.

Pjesa C: Procedura të tjera për zgjedhjen e konsulentëve

1. Përzgjedhja që bazohet në cilësitë e konsulentëve

Shërbimet për analiza që janë vlerësuar se kushtojnë më pak se \$30.000 (ekuivalenti i monedhave të tjera) për çdo kontratë mund të sigurohen sipas kontratave të përfunduara në përputhje me paragrafet 3.1 dhe 3.7 të Udhëzimeve për Konsulentin.

2. Përzgjedhja në bazë të koston më të ulët

Shërbimet për kontrollet financiare që janë vlerësuar se kushtojnë më pak se \$20.000 (ekuivalenti i monedhave të tjera) për çdo kontratë mund të sigurohen sipas kontratave të përfunduara në përputhje me paragrafet 3.1 dhe 3.6 të Udhëzimeve për Konsulentin.

3. Konsulentët Individualë

Shërbimet për detyrat e ngarkuara që i përmbushin kërkesat e paraqitura në paragrafin 5.1 të Udhëzimeve për Konsulentin do të sigurohen sipas kontratave të përfunduara me konsulentët individualë në përputhje me paragrafet 5.1 deri në 5.3 të Udhëzimeve për Konsulentin.

4. Përzgjedhja, duke u bazuar vetëm në një burim.

Me pëlqimin paraprak të Organizatës, shërbimet për trajnime mund të sigurohen në përputhje me paragrafët 3.8 deri në 3.11 të Udhëzimeve për Konsulentin.

Pjesa D. Rishikimi i përzgjedhjes së konsulentëve nga Organizata

1. Planifikimi i përzgjedhjes

Para se t'i jepen konsulentëve kërkesat për propozime, plani i propozuar për përzgjedhjen e konsulentëve sipas Projektit do t'i jepet Organizatës për rishikim dhe miratim në përputhje me paragrafin 1 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentin. Përzgjedhja e të gjitha shërbimeve të konsulentëve do të bëhet në përputhje me planin e përzgjedhjes që ka miratuar Organizata dhe me paragrafin 1.

1. Rishikimi paraprak

(a) Për secilën kontratë për punësimin e firmave konsulente që është vlerësuar se kushton \$50.000 ose më shumë (ekuivalenti i monedhave të tjera), do të zbatohen procedurat e paraqitura në paragrafet 1, 2 (përveç nënparagrafit të tretë të paragrafit 2 (a)) dhe 5 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentin.

(b) Për secilën kontratë punësimi të konsulentëve individualë që është vlerësuar se kushton \$20.000 ose më shumë (ekuivalenti i monedhave të tjera) dhe për kontratat e bazuara në një burim të vetëm, cilësitë dhe aftësitë, eksperiencat, termat e referencës dhe termat e punësimit të konsulentëve do t'i jepen Organizatës për rishikim dhe miratim. Kontrata do të përfundojë vetëm pasi të jetë dhënë ky miratim.

1. Rishikimi i mëvonshëm

Për secilën kontratë që nuk rregullohet nga paragrafi 2 i kësaj Pjese, do të zbatohen procedurat e paraqitura në paragrafin 4 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentin.

SHTESA IV Programi i Zbatimit

1. Huamarrësi:

a) ndjek ato politika dhe procedura që e lejojnë atë të vëzhgojë dhe të vlerësojë në vazhdimësi, në përputhje me ato tregues që janë të pranueshëm për Organizatën, zbatimin e Projektit dhe plotësimin e objektivave të tij;

b) përgatit, sipas termave të referencës që janë të pranueshme për Organizatën, dhe i paraqet Organizatës, afërsisht në fund të çdo viti kalendarik, një raport që përmban rezultatet e vëzhgimit dhe të vlerësimit që janë kryer sipas paragrafit (a) të këtij Seksioni, rreth progresit që është bërë në zbatimin e Projektit gjatë periudhës para datës së këtij raporti si dhe masat që janë rekomanduar për të siguruar zbatimin efikas të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij gjatë periudhës që vijon pas kësaj date; dhe

c) rishikon se bashku me Organizatën, 60 ditë pas kohës së treguar në nënparagrafin (b) të këtij paragrafi, ose në atë datë që e kërkon Organizata, raportin e treguar në paragrafin (b) të këtij Seksioni, dhe pas kësaj, të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar kryerjen efikase të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij, duke u bazuar në përfundimet dhe rekomandimet e raportit të sipërpermendur dhe pikëpamjet e Organizatës rreth kësaj çështjeje.

SHTESE V Llogaria e Veçantë

1. Në kuptim të kësaj Shtese:

(a) termi “Kategori që i plotësojnë kushtet” do të thotë kategoritë nga 1 deri në 4 të paraqitura në tabelen e paragrafit 1 të Shtesës I të kësaj Marrëveshjeje;

(b) termi “shpenzime që i plotësojnë kushtet” do të thotë shpenzime për koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin dhe që duhen financuar me shumën e Kredisë që janë caktuar kohë pas kohë për kategoritë që i plotësojnë kushtet në përputhje me Shtesën I të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(c) termi “Zë i Autorizuar” do të thotë shumën e barazvlefshme me \$700.000 që duhet tërhequr nga Llogaria e Kredisë dhe duhet depozituar në Llogarinë e Veçantë në përputhje me paragrafin 3(a) të kësaj Shtese, gjithsesi me kusht që në qoftë se Organizata nuk bie dakord përndryshe, Zëri i Autorizuar do të kufizohet deri në shumën e barazvlefshme me \$350.000 derisa shumën e përgjithshme të tërheqjeve nga Llogaria e Kredisë plus shumën totale të të gjitha angazhimeve të veçanta të detyrimeve të pashlyera që ka marrë përsipër Organizata në përputhje me Seksionin 5.02 të Kushteve të Përgjithshme të arrijë ose të tejkalojë ekuivalentin prej 1.500.000 DVMF.

2. Pagesat nga Llogaria e Veçantë do të bëhen vetëm për shpenzimet që i plotësojnë kushtet në përputhje me dispozitat e kësaj Shtese.

3. Pasi Organizata të ketë marrë prova të kënaqshme që Llogaria e veçantë është hapur ashtu siç duhet, tërheqjet e Zërit të Autorizuar dhe tërheqjet e mëpasme për të rimbushur Llogarinë e veçantë do të bëhen si vijon:

(a) Për tërheqjet e Zërit të Autorizuar, Huamarrësi do t'i paraqesë Organizatës një kërkesë ose kërkesa për depozita në Llogarinë e Veçantë të një shume apo shumave që nuk e kalojnë shumën e përgjithshme të Zërit të Autorizuar. Duke u bazuar në këtë kërkesë ose kërkesa, Organizata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe do të depozitojë në Llogarinë e veçantë atë shumë ose ato shuma që Huamarrësi ka kërkuar.

(b) (i) Për rimbushjen e Llogarisë së Veçantë, Huamarrësi do t'i paraqesë Organizatës kërkesa për depozita në Llogarinë e Veçantë në ato intervale kohore që do të përcaktojë Organizata.

(ii) Përpara ose në kohën e kësaj kërkesë, Huamarrësi do t'i paraqesë Organizatës dokumente dhe evidenca të tjera të kërkuara në përputhje me paragrafin 4 të kësaj Shtese për pagesën ose pagesat në lidhje me të cilat është kërkuar rimbushja. Mbi bazën e secilës kërkesë, Organizata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe do të depozitojë në Llogarinë e Veçantë atë shumë që ka kërkuar Huamarrësi dhe që në dokumentet dhe evidencat e sipërpërmendura do të tregohet se është tërhequr nga Llogaria e Veçantë për shpenzime që i plotësojnë kushtet. Të gjitha këto depozita do të tërhiqen nga ana e Organizatës nga Llogaria e Kredisë sipas Kategorive përkatëse që i plotësojnë kushtet dhe në shumat ekuivalente përkatëse që provohen si të nevojshme nga dokumentet dhe evidencat e tjera.

4. Për çdo pagesë që bën Huamarrësi nga Llogaria e Veçantë, Huamarrësi, kur kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Organizata, do t'i paraqesë Organizatës dokumente dhe evidenca të tjera që tregojnë se këto pagesa janë bërë vetëm për shpenzime që i plotësojnë kushtet.

5. Pavarësisht nga paragrafi 3 i kësaj Shtese, Organizatës nuk do t'i kërkohet të bëjë derdhje të mëtejshme në Llogarinë e Veçantë:

(a) në qoftë se, në çdo kohë, Organizata do të ketë vendosur që të gjitha tërheqjet e tjera do të bëhen nga Huamarrësi direkt nga Llogaria e Kredisë në përputhje me Nenin V të Kushteve të Përgjithshme dhe paragrafin (a) të Seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) në qoftë se Huamarrësi nuk arrin t'i paraqesë Organizatës, brenda periudhës kohore të përcaktuar në Seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë nga raportet e kontrollit të kërkuara për t'iu paraqitur Organizatës në përputhje me Seksionin e sipërpërmendur në lidhje me kontrollin e regjistrimeve dhe të llogarive për llogarinë e Veçantë;

(c) në qoftë se, në çdo kohë, Organizata do t'i ketë njoftuar Huamarrësit synimin e saj për të pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Kredisë në përputhje me Seksionin 6.02 të Kushteve të Përgjithshme; ose

(d) sapo shuma e përgjithshme e tërhequr e Kredisë së dhënë për Kategoritë që i plotësojnë kushtet, minus shumën e përgjithshme të të gjitha angazhimeve të veçanta të pashlyera të ndërmarra nga Organizata në përputhje me Seksionin 5.02 të Kushteve të Përgjithshme në lidhje me Projektin të barazojë ekuivalentin e dyfishit të shumës së Zërit të Autorizuar.

Pas kësaj, tërheqja nga Llogaria e Kredisë e shumës së mbetur të Kredisë se patërhequr që i është akorduar Kategorive që i plotësojnë kushtet do t'i nënshtrohet procedurave që Organizata do t'ia njoftojë Huamarrësit. Këto tërheqje të mëtejshme do të bëhen vetëm pasi dhe deri në masën që Organizata do të pranonte që të gjitha këto shuma që mbesin në depozitë në Llogarinë e Veçantë në datën e këtij njoftimi të përdorëshin për të bërë pagesa për shpenzimet që i plotësojnë kushtet.

6. (a) Në qoftë se Organizata do të ketë përcaktuar në çdo kohë se çdo pagesë nga Llogaria e Veçantë: (i) ishte bërë për një shpenzim ose në një shumë që nuk i plotëson kushtet në përputhje me paragrafin 2 të kësaj Shtese; ose (ii) nuk ishte mbështetur me evidencën që i është paraqitur Organizatës, Huamarrësi, me të marrë njoftim nga Organizata: (A) do të paraqesë ato evidenca shtesë që mund të kërkojë Organizata; ose (B) do të depozitojë në Llogarinë e Veçantë (ose, në qoftë se Organizata e kërkon, t'i kthejë Organizatës) një shumë të barazvlefshme me shumën e kësaj pagese ose me pjesën që nuk i plotëson kushtet ose që nuk është e justifikuar. Po qe së Organizata nuk bie dakord përndryshe, nuk do të bëhet asnjë depozitim i mëtejshëm nga ana e Organizatës në

Llogarinë e Veçantë derisa Huamarrësi të ketë paraqitur këtë provë ose të ketë bërë këtë depozitim ose kthim të parave, siç mund të jetë rasti.

(b) Në qoftë se Organizata do të jetë përcaktuar në çdo kohë se çdo pagesë e pashlyer në Llogarinë e Veçantë nuk do të kërkohet për të mbuluar pagesa të mëtejshme për shpenzimet që i plotësojnë kushtet, atëherë Huamarrësi, me të marrë njoftim nga Organizata, do t'ia kthejë këtë shumë të pashlyer Organizatës.

(c) Pasi të ketë njoftuar Organizatën, Huamarrësi mund t'i kthejë Organizatës të gjithë ose një pjesë të fondeve që janë në Llogarinë e Veçantë.

(d) Shumat e kthyera Organizatës në përputhje me paragrafët 6 (a), (b) dhe (c) të kësaj Shtese do të kreditohen në Llogarinë e Kredisë për tërheqje të mëtejshme ose për anulim në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë Kushtet e Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 7.7.2000
Doli nga shtypi më 7.7.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 100 lekë